

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

UNMIK

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

LIGJI Nr. 2003 / 8

**MBI VENDOSJEN E TATIMIT NË PRONËN E
PALUAJTSHME NË KOSOVË**

Kuvendi i Kosovës,

Duke marrë parasysh Rregulloren Nr. 1999/1 të datës 25 Korrik 1999 të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), sikurse është ndryshuar, “Mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë”,

Duke njohur se Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/9 e datës 15 Maj 2001, “Mbi Kornizën Kushtetuese për Vet-qeverisje të Përkohshme në Kosovë”, Neni 5.1(b), i transferon përgjegjësitë për çështjet fiskale tek Institucionet e Përkohshme të Vet-qeverisjes (IPVQ),

Me qëllim të mundësimin të komunave që të mbleshin të ardhura në përputhje me ligjet dhe udhëzimet e Autoritetit Qendror në përputhje me Rregulloren Nr. 2000/45 të datës 11 Gusht 2000 “Mbi Vet-Qeverisjen e Komunave në Kosovë”, Neni 39,

Duke njohur se Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/23 e datës 29 Shtator 2001 “Mbi Programin Pilot për Vendosjen e Tatimit në Pronën e Paluajtshme në Kosovë”, e cila ofron një program preliminarë për vendosjen e tatimit mbi pronën e paluajtshme, skadon më 31 Dhjetor 2002;

Me qëllim të themelimit të një ligji gjithpërfshirës i cili i qeverisë tatimet e tilla në Kosovë,

Në këtë mënyrë nxjerr këtë që vijon:

Kapitulli 1

Vendosja e Tatimit në Pronë

Neni 1

Definicionet

“Pronë e Paluajtshme “ do të thotë toka dhe ndërtesat, stabilimentet ose strukturat mbi ose nën sipërfaqen e tokës, të cilat janë të lidhura për tokë. Prona e Paluajtshme i përfshin lokalet brenda ndërtesave, duke i numëruar ndër të tjera edhe apartamentet ose sipërfaqet e shfrytëzuara për aktivitete komerciale

“Regjistri i të drejtave të pronës së paluajtshme” do të thotë regjistri i themeluar nga Agjencioni Kadastral i Kosovës për regjistrimin dhe legalizimin e të drejtave në pronën e paluajtshme.

“Agjencioni Kadastral i Kosovës ” (AKK) do të thotë agjencioni ekzekutiv përbrenda Ministrisë së Shërbimeve Publike që është përgjegjës për administrimin e përgjithshëm të regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme.

“Vlera e tregut” do të thotë çmimi me të cilin blerësi është i gatshëm të blejë dhe me të cilin shitësi është i gatshëm ta shes pronën e paluajtshme ku asnjëri palëve nuk është i shtrënguar për të vepruar dhe ku nuk ekziston ndonjë marrëdhënje ndërmjet palëve siq janë; lidhjet familjare, martesës, pronësisë së përbashkët apo bashkimit afarist.

“Zyret Kadastrale Komunale” janë zyre të autorizuara dhe të mbikëqyrura nga Agjencia Kadastrale e Kosovës për regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme në regjistrin e të drejtave të pronës së paluajtshme.

“Pronari i pronës” do të thotë personifikim apo juridik i cili mban titullin e pronës apo i cili është i regjistruar si pronar i pronës në regjistrin e të drejtave të pronës së paluajtshme.

“Baza e të dhënave të tatimit mbi pronën” do të thotë baza e të dhënave të themeluar nga komuna për të mirëmbajtur informacionin e tatimit mbi pronën siq janë emrat dhe adresat e pronarëve dhe shfrytëzuesve të pronës, informacioni mbi ndërtesat, vlera e pronës, shkalla tatimore, faturat tatimore, dhe shënimet e pagesave të tatimeve.

“Fatura Tatimore” do të thotë dokumenti i lëshuar nga komuna tek tatimpaguesi që e njofton tatimpaguesin lidhur me detyrimin e tij tatimor për periudhën tatimore.

“Periudha tatimore” do të thotë viti kalendarik.

Neni 2

Dispozitat e Përgjithshme

- 2.1. Ky ligj vendosë tatimin mbi pronën e paluajtshme dhe i përcakton standardet dhe procedurat të cilat duhet t'i ndjekin komunat në administrimin e tatimit.
- 2.2. Të ardhurat e mbledhura nga tatimi në pronë do të mbesin në komunë dhe do të shfrytëzohen nga komuna në përputhshmëri me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë.

Neni 3

Objekti i Tatimit

Tatimi mbi pronën do të vendoset në të gjitha pronat e paluajtshme në Kosovë, përveq atyre të përjashtuara nga pagimi, të përcaktuar në nenin 7 të këtij Ligji.

Neni 4

Tatimpaguesi

- 4.1 Tatimpaguesi, në rend të parë, është pronari i paluajtshmërisë.
- 4.2 Nëse pronari i pronës nuk mund të përcaktohet apo nuk mund të lokalizohet, tatimpaguesi është personi fizik apo juridik i cili e shfrytëzon pronën e paluajtshme.
- 4.3 Nëse nuk mund të caktohet pronari i pasurisë së paluajtshme, ose mund të caktohet, por nuk ka qasje në atë pasuri të paluajtshme, obliguesi tatimor do të jetë personi fizik apo juridik që shfrytëzon atë pasuri, pa të drejtë legalizimi.

Neni 5

Baza Tatimore

- 5.1 Baza tatimore për tatimin në pronë do të jetë vlera e tregut e pronës e përcaktuar në përputhshmëri me standardet e vendosura në Nenin 12.
- 5.2 Për çdo vit tatimor, vlera e tregut e çdo prone është vlera e pronës më 31 Dhjetor të vitit paraprak.

Neni 6

Shkalla Tatimore

- 6.1 Asambleja Komunale e çdo komuneje do t'i vendosë shkallën tatimore të tatimit mbi pronën në baza vjetore ndërmjet 0.05 % dhe 1 % të vlerës së pronës.
- 6.2 Shkalla tatimore mund të ndryshojnë ndërmjet kategorive në vijim të pronës:
- (a). Prona e domosdoshme për banim : prona e paluejtshme që shërben për krijimin e kushteve elementare për banim të njerëzve, duke nënkuptuar këtu shtëpitë apo apartamentet , apo të ngjajshme.
 - (b). Prona e banuar : prona e cila shfrytëzohet apo mbahet si objekte ndihmesë për banim dhe jetesë të njerëzve, siq janë tokat, garazhat, hapësirat për parking, apo ndonjë objekt tjetër ndihmës joafarist.
 - (c). Prona komerciale: prona që shfrytëzohet apo mbahet për shfrytëzim për qëllime afariste, siq janë; ato për ndonjë qëllim komercial, afarist, shitjeje me pakicë, tregti, shërbimi rekreacional, artistik, sportiv, si dhe ato arsimore, mjekësore (private).
 - (d). Prona Industriale: pronë e shfrytëzuar për prodhimin, përpunimin trajtimin dhe ruajtje të mallërave, duke përfshirë fabrikat, depot, punëtoritë, dhe objektet tjera përkatëse;
 - (e). Prona bujqësore: toka dhe ndërtesat e shfrytëzuara për qëllime bujqësore.
 - (f). Pasuria e paluajtshme e lënë pas dore (djerrina) dhe objektet e pabanuara.
- 6.3 Shkalla tatimore të përcaktuara për pronën në kategoritë 6.2 (c) dhe 6.2 (d) nuk do të jenë më të mëdha se 2.5 herë se sa shkalla tatimore për pronën në kategorinë 6.2 (b)
- 6.4 Shkalla tatimore të përcaktuara për pronën në katëgoritë 6.2 (c) dhe 6.2 (d) nuk do të jenë më të mëdha se 4 herë nga shkalla tatimore për pronën në kategorinë 6.2 (e)

Neni 7

Prona e përjashtuar nga tatimi

- 7.1 Prona në vijim do të përjashtohet nga tatimi në pronë:
- (a) prona në pronësi apo në shfrytëzim të Institucioneve Vetëqeverisëse të Kosovës;
 - (b) prona në pronësi apo në shfrytëzim të një qeverie të huaj, agjensioni të qeverisë së huaj, organizate ndërkombëtare qeveritare ose agjensioni donatorë të huaj që kryen punë të ndihmës humanitare, rindërtimit, administratës civile apo asistencës teknike përbrenda Kosovës;
 - (c) prona në pronësi apo në shfrytëzim të Kombeve të Bashkuara dhe agjensionve të specializuara të saj;
 - (d) prona në pronësi apo në shfrytëzim të KFOR-it;
 - (e) prona në pronësi apo në shfrytëzim të një organizate jo-qeveritare me status të përfitimit publik që përputhet me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/22 të 15 Nëntorit mbi Regjistrimin dhe Veprimin e Organizatave Jo-Qeveritare në Kosovë;
 - (f) Pronat e Institucioneve fetare që shfrytëzohen si objekt kulti.
- 7.2 Përjashtimet në Nenin 7.1 nuk vlejnë nëse:
- (a) prona shfrytëzohet apo mbahet për shfrytëzim për aktivitete komerciale ose për krijimin e të ardhurave;
 - (b) prona që është në pronësi apo në shfrytëzim nga një organizatë me status të përfitimit publik e që nuk shfrytëzohet ekskluzivisht për qëllimin e saj të përfitimit publik;

Neni 8

Standardi për pronën e domosdoshme për banim dhe zbritja e tatimit për këtë pronë

- 8.1. Pronë e domosdoshme për banim konsiderohet 20 m/2 (metra në katror) për kokë banori.

8.2. Një person fizik i cili, më ose para 1 Marsit të periudhës tatimore vendos që prona apo njësi e banimit shërben si pronë e domosdoshme për banim, do t'i lejohet një zbritje prej 15.000 Euro nga vlera e pronës.”

Neni 9

Regjistrimi dhe Informacioni i Pronës

- 9.1 Të gjithë personat të cilët kanë në pronësi, pronën e paluajtshme, qoftë e përjashtuar nga tatimi apo jo nën ligjin e tanishëm, duhet regjistruar pronën e paluajtshme në bazën e të dhënave të tatimit pranë komunës më ose para 1 Marsit të çdo viti tatimor.
- 9.2 Të gjithë personat të cilët kanë në pronësi, shfrytëzim apo e banojnë pronën e paluajtshme duhet të ofrojnë tek komuna informacionin që ka të bëjë me pronën e paluajtshme ashtu siq kërkohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave me udhëzimin administrativ.
- 9.3 Të gjithë personat të cilët kanë në pronësi, shfrytëzim apo e banojnë pronën e paluajtshme duhet që të lejojnë autoritetet komunale të tatimit mbi pronë që të hynë në tokë dhe objekte në kohëra të arsyeshme me qëllim të mbledhjes së të dhënave për vlerësimin e pronës.

Kapitulli II

Administrata Tatimore

Neni 10

Përgjegjësitë e Komunës

- 10.1 Çdo komunë do të jetë përgjegjëse për funksionet vijuese në administrimin e tatimit mbi pronën:
 - (a) menaxhimi i informatave për tatimin në pronë;
 - (b) vlerësimin e pronës për tatim;
 - (c) përgaditjen dhe lëshimin e faturave të tatimit;
 - (d) mbledhjen dhe mbledhjen e detyrueshme të tatimeve;
 - (e) ankesat administrative.

- 10.2 Funkcionet e mbledhjes dhe ankesave administrative duhet t'i përcaktohen departamenteve të pavarura apo seksioneve përkatëse të komunës.

Neni 11

Informacioni për Tatimin mbi Pronën

- 11.1 Çdo komunë duhet të themelojë dhe mirëmbajë një bazë të të dhënave për tatimin mbi pronën duke përfshirë, tërë informacionin për tatimin mbi pronën, duke mos u kufizuar vetëm në, adresat e pronës, adresat e pronarëve të pronës dhe shfrytëzuesve, të dhënat mbi tokën dhe objektet, vlerat e pronave, shkalla tatimore, faturat tatimore, dhe shënimet mbi pagesat e tatimeve.
- 11.2 Agjencia kadastrale e Kosovës përmes zyreve kadastrale komunale duhet të transferojnë tërë informacionin mbi regjistrimin e pronës prej regjistrit të të drejtave të proëns së paluajtshme tek baza e të dhënave të tatimit mbi pronën. Komunat duhet të transferojnë tek zyret kadastrale komunale ndryshimet e informacionit mbi regjistrimin e pronës në intervale të tilla që do të përcaktohen nga Agjensioni Kadastral i Kosovës.
- 11.3 Informacioni në bazën e të dhënave për tatimin mbi pronë do të jetë i gatshëm për qytetarët.

Neni 12

Vlerësimi i Pronës

- 12.1 Ministria e Ekonomisë dhe Financave do të përshkruajë në udhëzimet administrative, standarde uniforme të vlerësimit në bazë të së cilave komuna do të përcaktojë vlerën e tregut të pronës. Standardet duhet të përfshijnë ndryshoret relevante të vlerësimit siq janë të hyrat e prodhuara nga prona, kostoja e ndërtimit, lokacioni, sipërfaqja, dhe gjendja e pronës. Standardet do të bazohen në vlerësime të përgjithshme, përveq në raste të veqanta ose të ndonjë prone të ndërtuar në mënyrë unike.
- 12.2 Çdo komunë duhet të përcaktojë vlerën e tregut për pronat në juridiksionin e saj në përputhshmëri me standardet e përshkruara me Nenin 12.1.
- 12.3 Komunat rishikojnë dhe rivlersojnë vlerën e tregut të pronës çdo tre deri në pesë vjet.

- 12.4 Komunat rivlerësojnë një pronë çdo vit nëse në pronë janë bërë ndërtime të reja apo përmirësime substanciale, ose nëse është bërë ndonjë ndryshim në shfrytëzimin e pronës.
- 12.5 Pronari i pronës apo shfrytëzuesi mund të kërkojë nga komuna që të rivlerësojë pronën nëse prona është dëmtuar dhe shfrytëzuesi apo pronari nuk kanë qenë përgjegjës për këtë. Dëmtime të tilla mund të jenë si pasojë e thatësisë, vërshimeve, zjarrit, termetit, luftës apo ndonjë katastrofe tjetër.

Neni 13

Faturat Tatimore

- 13.1 Për vitin tatimorë 2002, komunat të cilat ishin çertifikuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/23 të datës 29 Shtator 2001 “Mbi Programin Pilot për Vendosjen e Tatimeve në Pronën e Paluajtshme në Kosovë” për të lëshuar faturat tatimore, duhet të bëjnë këtë më ose para 31 Marsit 2003.
- 13.2 Për vitin tatimor 2003, komunat do të lëshojnë fatura tatimi më ose para 1 Shtatorit, 2003.
- 13.3 Për vitet vijuese, pas 2003, komunat do të lëshojnë faturat tatimore më ose para 31 Marsit të çdo viti.
- 13.4 Fatura tatimore duhet të përfshijë informacionin vijues:
- (a) identifikuesin e bazës së të dhënave të tatimit mbi pronën;
 - (b) emrin e tatimpaguesit;
 - (c) adresën e pronës;
 - (d) adresën për dërgimin e faturave tatimore, nëse kjo është e ndryshme prej adresës së pronës;
 - (e) vlerën e vlerësuar të pronës;
 - (f) shkalla tatimore;
 - (g) tatimin e tërsishëm për tu paguar;
 - (h) datën në të cilën pagesa duhet bërë;

- (i) vendin dhe metodën e pagimit të faturës tatimore.
- (j) e drejta dhe procedura e ankesës në faturën tatimore.

Neni 14

Pagesat e tatimit

- 14.1 Për vitin tatimor 2002, tatimi i vendosur nën Rregulloren Nr. 2001/23 të datës 29 Shtator 2001 “Mbi Programin Pilot të Vendosijes së Tatimit mbi Pronën e Paluajtshme në Kosovë” duhet të paguhet më ose para 31 Majit 2003.
- 14.2 Për vitin tatimor 2003, tatimi i vendosur nga ky ligj do të paguhet më ose para 31 Marsit 2004.
- 14.3 Për vitin tatimor 2004 dhe vitet pasuese, tatimi i vendosur nga ky ligj do të paguhet në dy pjesë të barabarta më ose para 30 Qershorit dhe 31 Dhjetorit të vitit tatimorë.

Neni 15

Shtyerjet Tatimore

- 15.1 Komuna mundet, në raste të veqanta kur vlerëson se pagimi i tatimit do t'i shkaktonin tatimpaguesit mundime të tepruara, të lejojë tatimpaguesit që të shtyjnë pagimin e tatimit për një faturë specifike tatimore dhe kjo është e kufizuar për një periudhë kohore e cila nuk tejkalon 2 vite.
- 15.2 Tatimpaguesi nga neni 15.1 gjatë procedurës së apelit duhet të prezentoj dëshmi të mjaftueshme që për rastin konkret të aplikohet shyerja e tatimit në prone.

Neni 16

PenguTatimor si Garanci Pagese

- 16.1 Çdo tatim i papaguar sipas këtij ligji do të vendoset në peng mbi pronën për dobi të Komunes pa marr parasysh nëse është apo nuk është i identifikuar pronari .
- 16.2 Nëse Komuna e regjistron pengun si garanci e pageses në regjistrin e të drejtave për pronën e paluajtshme, një peng i tillë, do të jetë valid kundrejt të gjitha të drejtave në pronë dhe do të ketë prioritet mbi të gjitha pengjet tjera të garancisë së pagesës në lidhje me pronën e tillë.”

- 16.3 Personi prona e të cilit është bërë peng i një pagese tatimore për shkak të regjistrimit të gabuar nga komuna, mund të paraqesë ankesë në komunë për lirimin nga pengu i tillë. Tatimpaguesi do të jetë ai që do të dëshmojë se pengu i tillë është regjistruar në mënyrë të gabuar.”

Neni 17

Vjelja e detyrueshme

- 17.1 Drejtorët Komunal të Financave do të caktojnë tatimbledhësit komunal për të zbatuar mbledhjen e tatimit.
- 17.2 Aty ku tatimpaguesi nuk e ka paguar tatimin që duhet paguar, tatimbledhësit komunal mund t'i japin tatimpaguesit një vrejyje me shkrim për qëllimin e konfiskimit të pronës që i përket një personi të tillë. Vrejjtja e tillë duhet:
- (a) të dërgohet tek tatimpaguesi (i cili do të konsiderohet i vlefshëm edhe kur tatimpaguesi e refuzon dokumentin);
 - (b) të lihet në vendin e banimit apo vendin e zakonshëm të biznesit të tatimpaguesit; apo
 - (c) të dërgohet me postë tek adresa e fundit e njohur e tatimpaguesit.
- 17.3 Nëse tatimpaguesi nuk e ka paguar shumën e plotë të tatimit, ndëshkimet, dhe interesin përbrenda 10 ditëve të dërgimit të njoftimit për qëllimin e konfiskimit, do të jetë e ligjshme për tatimbledhësit komunal që:
- (a) të mbledhin nga personi i cili i ka borxhë tatimpaguesit pagën, qiran apo ndonjë borxh tjetër;
 - (b) të mbledhin nga banka apo ndonjë palë e tretë që posedon ndonjë pasuri të tatimpaguesit;.
 - (c) të ndërprejnë shërbimet komunale për pronën e tatimpaguesit;
 - (d) të kufizojnë të drejtat e tatimpaguesit në pronën e tij;
 - (e) të konfiskojnë dhe shesin pronën personale të tatimpaguesit.
- 17.4 Nga konfiskimi do të përjashtohen: pagesat për përkujdesjen e fëmijës dhe ndihma sociale, veshëmbathja e domosdoshme, ushqimi themelor, orenditë themelore, gjërat personale themelore, duke përjashtuar gjërat luksoze, dhe mjetet e punës të tatimpaguesit.

- 17.5 Rregullat dhe procedurat për mbledhjen e detyrueshme të tatimit mbi pronën nën këtë Nen do të jenë të njëjta me ato të përcaktuara në Ligjin mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Neni 18

Humbja e Pronës

- 18.1 Nëse, pas dy viteve nga vërejtja për qëllimin e konfiskimit, obligimi i tatimpaguesit ende nuk është paguar, komuna mund të dërgojë një njoftim për konfiskim tek të gjithë personat që kanë interes në pronë.
- 18.2 Nëse pagesa nuk është bërë brenda 30 ditëve të dërgimit të njoftimit për konfiskim, për afërsisht komuna mund ta shesë pronën apo një pjesë të saj vlera e së cilës është e barabart me vlerën e borxhit tatimor të tatimpaguesit, në ankand publik, në përputhje me rregullat dhe procedurat e vendosura për Administratën Tatimore.”
- 18.3 Pas përfundimit të shitjes dhe pasi që ofertuesi më i lartë të ketë paguar shumën e plotë të ofertës, gjygi do të lëshojë një vendim mbi bartjen pronësis tek ofertuesi më i sukseshëm.
- 18.4 Prona e shitur në ankand publik sipas këtij ligji do të jetë e liruar nga detyrimet e mëparshme tatimore edhe nëse komuna nuk e merrë shumën e plotë të tatimit të papaguar.
- 18.5. Për shkak të borxhit të tatimpaguesit , nuk mund të konfiskohet e as të shitet në ankand publik e as të tjetërsohet në formë tjetër të detyrueshme prona e domosdoshme për banim.

Neni 19

Ndëshkimet

- 19.1 Çdo tatimpagues i cili nuk e regjistron pronën e tij në zyrën kadastrale komunale në përputhje me Nenin 9.1 ose i cili nuk ofron informacion mbi tatimin në pronë tek komuna sikurse kërkohet me Nenin 9.2, do të humb të drejtën për t'u ankuar në faturën tatimore.
- 19.2 Çdo tatimpagues që refuzon të drejtën e inspektimit në përputhje me Nenin 9.3, duhet të pajtohet që të lejojë inspektimin brenda 60 ditëve nga refuzimi fillestarë ose e humb të drejtën për t'u ankuar në faturën tatimore në një ankesë administrative.

- 19.3 Çdo tatimpagues i cili nuk paguan tatimin në pronë më ose para datës së fundit të caktuar për pagesë do të ndëshkohet me një shumë që kap 5% të detyrimit tatimorë.
- 19.4 Çdo tatimpagues i cili nuk ka paguar tatimin në pronë brenda 60 ditëve pas datës së fundit të caktuar për pagesë do të ndëshkohet me një shumë shtesë prej 10% të detyrimit tatimor.

Neni 20

Kamata

- 20.1 Kamata do të llogaritet në tatimet dhe ndëshkimet e papaguara në një shkallë vjetore të vendosur dhe të publikuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave për Administratën Tatimore.
- 20.2 Kamata do të llogaritet në baza mujore prej datës kur tatimi ka skaduar të paguhet dhe deri në datën kur tatimi paguhet..

Neni 21

Ankesat Administrative

- 21.1 Tatimpaguesi i cili mendon se vlera e vlerësuar e pronës nuk paraqet vlerën e tregut, se ekzistojnë gabime në bazën e të dhënave të tatimit mbi pronë, në bazë të së cilës fatura tatimore është bazuar, ose që tatimi është i pasaktë, mund të kërkojë rishqyrtimin e llogarisë tatimore nga ana e Bordit komunal për ankesa në tatim në pasurinë e paluajtshme”
- 21.2 Kërkesa e tatimpaguesit për rishqyrtim duhet të paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i faturës tatimore, dhe duhet të jetë në formën me shkrim, së bashku me dokumentacionin provues përkrahës të cilin tatimpaguesi dëshiron ta prezentoj”.
- 21.3 Kërkesa e tatimpaguesit për rishqyrtim nuk e pezullon detyrimin e tij për të paguar tatimin.
- 21.4 Pavarësisht nga Neni 21.3, komuna nuk do të shfrytëzojë procedurat e mbledhjes së detyrueshme të tatimit derisa të mirret një vendim mbi kërkesën e tatimpaguesit.
- 21.5 Përbrenda 60 ditëve nga data e kërkesës, divizioni i ankesave duhet të njoftojë tatimpaguesin për vendimin e tij.

- 21.6 Nëse është vendosur sipas ankesës në favor të tatimpaguesit, atëherë komuna do t'i rikthej tatimpaguesit shumën e tatimit dhe kamatën e rritur, në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së vendimit nga ana e Seksionit për ankesa.”
- 21.7 Tatimpaguesi i cili nuk pajtohet me vendimin e divizionit të ankesave mund të ankohet në gjykatën kompetente për rishqyrtimin e vendimit të marrë nga komuna.

Neni 22

Certifikimi nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave

- 22.1 Komuna duhet të posedojë certifikat valide nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave në mënyrë që të lëshojë faturat tatimore dhe të mbledhë tatimin në pronë në përputhje me këtë ligj.
- 22.2 Për të marrë certifikimin, komuna duhet të demonstrojë tek Ministria e Ekonomisë dhe Financave që ka:
- (a) identifikuar dhe regjistruar karakteristikat fizike të pronës së tatimueshme dhe pronës së përjashtuar;
 - (b) themeluar një bazë të dhënash mbi tatimin në pronë;
 - (c) adaptuar kriteriumet e vlerësimit që janë në përputhje me kriteriumet e vendosura në Nenin 11.1;
 - (d) vendosë shkallët tatimore në pronë në përputhje me këtë ligj;
 - (e) themeluar një kapacitet administrativ për të menaxhuar informacionet mbi pronën, vlerësimin e pronës, faturimin, mbledhjen, mbledhjen e detyrueshme, dhe ankesat administrative.
- 22.3 Çertifikatat të cilat ishin lëshuar nga Autoriteti Qendror Fiskal tek komunat në bazë të dispozitave të Rregullores Nr. 2001/23 mbi Programin Pilot të Vendosjes së Tatimit mbi Pronën e Paluajtshme në Kosovë, do të jenë valide për qëllime të këtij ligji.
- 22.4 Të gjitha komunat që nuk janë certifikuar sipas Pilot Programit kërkohet që të certifikohen nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave më ose para 30 Qershorit 2003, sipas këtij ligji.
- 22.5 Ministria e Ekonomisë dhe Financave do të ndërmarrë inspektime vjetore të atyre komunave që janë certifikuar. Një inspektim i tillë do të sigurojë se shfrytëzohen

standardet e duhura të vlerësimit, se baza e të dhënave të tatimit mbi pronën mirëmbahet siq duhet, se procedurat e mbledhjes së detyrueshme aplikohen siq duhet, dhe se komuna është duke punuar në përputhje me ligjin.

22.6 Nëse inspektimi nën Nenin 22.5 zbulon se komuna është në kundërshtim me këtë ligj, Ministria e Ekonomisë dhe Financave do t'i lëshojë Komunës një vërejtje duke kërkuar nga komuna eliminimin e mospërputhshmërive dhe mënyren për përmirsimin e mospërputhshmërive të cekura.

22.7 Ministria e Ekonomisë dhe Financave mund të zhvleftësoj çertifikatën e çdo komune e cila nuk ka përmirësuar mospërputhshmërit e saj brenda një periudhe prej 90 ditëve nga pranimi i vërejtjes.

Neni 23

Ligji në Fuqi

Ky Ligj do të zëvendësojë çdo dispozitë në ligjin në fuqi e cila nuk është në përputhje me të.

Neni 24

Implementimi

Ministria e Ekonomisë dhe Financave do të lëshojë rregulla administrative për implementimin e këtij Ligji.

Neni 25

Hyrja në Fuqi

Ky Ligj do të hyjë në fuqi me 1 Prill 2003.

Ligji nr.2003 / 8
17 Prill 2003

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

Akademik Nexhat Daci